



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS

Durrës 26.01.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se:

1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2025?

*Jo, për vitin 2025 nuk është ofruar asnjë mbështetje financiare për OJF-të.*

2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa ka qenë buxheti i shtetit i alokuar vetëm për mbështetjen e organizatave jofitimprurëse gjatë vitit 2025? Sa nga ky buxhet u disbursua tek OJF-të?

3. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)?

4. Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2025? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë se një formë.

*Duke qenë se Bashkia Durrës nuk ka patur një buxhet të dedikuar për mbështetjen e OJF-ve, nuk është bërë asnjë thirrje në mënyrë që organizatat të aplikojnë.*

5. Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka patur më shumë se një formë.

6. Cili ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në total? Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.

7. Keni ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2025? Cila është baza ligjore/rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje?

*Mbështetjet jofinanciare kanë qenë të ofruara në vazhdimësi nga vitet e kaluara dhe për vitin 2025 nuk ka marrëveshje të reja.*

8. Nëse keni ofruar mbështetje jofinanciare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj.)?

*Bashkia Durrës ka ofruar mbështetje jofinanciare për dy OJF gjatë viteve të mëparshme dhe në vazhdim. Këto mbështetje janë të llojit “Kontratë huapërdorjeje” për dhënien në përdorim të ambienteve pa kundërshpërblim.*

9. Keni nënshkruar kontrata për mbështetje jo financiare? Nëse po, cila është baza ligjore për ofrimin e kësaj mbështetjeje?

*PO, për të dyja rastet është nënshkruar kontratë midis palëve, sipas ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, nenit 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, vendimeve përkatëse të Këshillit Bashkiak si dhe kërkesave të bëra nga OJF-të.*

10. Cili është numri i takimeve monitoruese nga numri total i projekteve fituese që keni kryer gjatë 2025? Ju lutem na siguronit një listë të kritereve monitoruese.

*Duke qenë se Bashkia Durrës nuk ka patur një buxhet të dedikuar për mbështetjen e OJF-ve, nuk është bërë asnjë thirrje në mënyrë që të ketë projekte fituese dhe rrjedhimisht as takime monitoruese.*

11. A është bërë një vlerësim impakti mbi fondin e disbursuar ndaj organizatave jofitimprurëse? A keni një raport të tillë vlerësimi? Nëse po, ju lutem bashkëngjisni atë.

*Duke qenë se nuk është disbursuar asnjë fond për OJF-të, nuk ka një raport vlerësimi.*

## **Bashkëpunimi me OJF-të**

1.Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2025?

*Gjate vitit 2025 jane bere 27 konsultime publike.*

2. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.

*Institucioni nuk ka një koordinator të emëruar për shoqërinë civile.*

3. Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga institucioni juaj? Si janë informuar ato?

*Gjatë vitit 2025 në konsultimet publike nga listprezencat e mbajtura kanë marr pjesë 5 përfaqesues nga OJF të ndryshme.*

4. Sa përqind (%) e projektligjeve/akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë konsultuar me OJF-të?

*Në dëgjesat publike gjithmonë ka pjesëmarrje të organizatave të shoqërisë civile.*

5. A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse Po, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshira në to?

*Organizata dhe përfaqësues të shoqërisë civile janë të përfshirë në organet këshillimore të bashkisë, si Këshilli Vendor Rinor dhe Komisioni Ad-Hock.*

6. A janë të përfshirë OJF në grupe pune të ngritura të institucionit tuaj? Nëse Po, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të përfshira në to?

*Po, OJF-të janë pjesë e grupeve të punës si GTN ( Gupi Teknik Ndërsektorial për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje), ETN (Ekipi Teknik Ndërsektorial për rastet e viktimave të dhunes në familje) dhe Komiteti Drejtues I MKR-së ( Mekanizmi i Koordinuar i Referimit për rastet e dhunës në familje), të ngritura nga Bashkia Durrës.*